



euronatur



Contact point

Albania:

ALBAGENE- Albanian National Association for Conservation, Development and Economic Sustainable Use of Farm Animal Genetic Resources
Chairman

Prof.Dr. Kristaq Kume

Rr."Abdyl Frasher" Pall.3/3. Ap.5

Tirana

Tel: 00 355 68 21 40 737

Fax: 00 355 22 414 03

E-mail: kkume@icc-al.org

SAVE Foundation, Head Office,
Joseph-Belli-Weg 5, D-78467
Konstanz

office@save-foundation.net

www.save-foundation.net

www.elbarn.net

16th March, 2010

Përmbajtja e Veprimeve

Rajoni jug-lindor evropian i projektit ELBARN përbëhet nga këto shtete: Shqipëria, Bosnia dhe Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Kosova UNMIK, FYR Maqedonisë, Mali i Zi, Romania, Serbia dhe Ukraina. Nga këto vende, vetëm dy janë anëtarë të BE, përkatësisht Bullgaria dhe Romania. Qëllimet e rekomanduara, kërkesat dhe veprimet janë diskutuar në një workshop në Blagoevgrad, Bullgari në Maj 2009 së bashku nga pjesëmarrësit nga vendet e lart përmendura. Diskutimet e workshopit konkluduan në Planin e Veprimit të publikuar këtu. Një qëllim kryesor i ELBARN-it është të krijojë një rrjet funksional Qendrash të Ruajtjes (A&RCs). Qendrat do të përdoren në emergjenca, të tilla si për moshat e vjetra të rracave të rëndësishme ose në rëniet e sëmundjeve infektive, për parandalimin e humbjes së rracave autoktone të gjësë së gjallë (bagëtime). Ato kanë gjithashtu një funksion të rëndësishëm për ngritjen e ndërgjegjes publike për rracat e gjësë së gjallë (bagëtime) dhe blegtorinë tradicionale, dhe për ruajtjen e rracave nëpërmjet mbarështimit.

Zona e Planit të Veprimit për Evropën Jug-Lindore kërkon veprimet e mëposhtme:

- Rracat e rralla duhet të miratohen me anë të legjislacionit për një trajtim të veçantë.
- Duhet të vazhdojë identifikimi i rracave dhe blegtorëve dhe të pasojë me një monitorim afatgjatë.
- Duhet të ngrihet një Zone Task Force për të kordinuar veprimet e ruajtjes, punën për planet e emergjencave, për të ndihmuar identifikimin e A&RCs dhe përgatitur informacionin.
- Blegtoria tradicionale duhet të mbështetet dhe përmirësohet nëpërmjet një legjislacioni më të mire dhe një informacioni më të mire për blegtorët dhe veterinerët.
- A&RCs potenciale duhet të identifikohen, kontaktohen, vizitohen dhe dokumentohen në database-n ELBARN.

Supported by the
European Union



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

SWISSLOS
Kanton St.Gallen

- Qendrat e ruajtjes dhe mbajtjes nevojitet te identifikohen, kontaktohen dhe fuqizohen per mbrojtjen e rracave te rralla ne rastet e rënies së sëmundjeve.
- Duhet te iniciohen projekte pilote për ti treguar blegtorëve të interesuar se si këto institucione ARC Pilot mund te ndihmojnë në qëndrueshmëri.
- Organizimet dhe shoqatat e blegtorëve duhet të krijohen edhe në vende qe nuk ekzistojnë ende. Cilësia e tyre duhet të jetë nën kontroll të vazhdueshëm.
- Duhet të krijohen bërthama organizimesh (grupimesh) në zone me qëllim që të mbrojnë rritjet dhe mbarështimet e rëndësishme.
- Ndërkohë që shkohet drejt standarteve evropiane, duhet të tregohet kujdes për ruajtjen e sistemeve të mbarështimit që janë unike në zone.
- Ndërgjegjja publike duhet të rritet nga promovimi nëpërmjet medias, nëpërmjet promovimit të produkteve dhe nëpërmjet edukimit.
- Duhet të bëhen llogaritje për përfitimet financiare për të treguar që rracat indigjene janë më përfituese se ato të huaja – këto llogaritje duhet të përfshijnë kostot ekologjike.
- Duhet të kryhet një vlerësim sistematik mbi ndikimet para futjes së rracave të reja në zone.
- Duhet të promovohen çështjet e shëndetit publik dhe ndërgjegjësimit për rëndësinë e produkteve cilësore.
- Duhet të veprohet në drejtim të bashkëpunimit ndërkufitar, shkëmbimit të eksperiencës dhe vizitave studimore.
- Duhet të organizohen workshop-e për të adresuar çështje të veçanta, si p.sh. organizimin e strukturave për OJF-të, etj.

Impakti i të gjitha këtyre veprimeve do të mundësojë një punë më të mire për ruajtjen e rracave tradicionale dhe vendeve ku ato jetojnë në këtë rajon.